

PLATFORMA E DIALOGUT – AGJENDA E REFORMAVE NË SHQIPËRI

Kemi kënaqësinë t'ju ftojme në tryezën e parë të të **N-CoMER**—një platformë e sapokrijuar dhe e udhëhequr nga shoqëria civile, që synon të mbështesë zbatimin e Agjendës së Reformave në Shqipëri në kuadër të Planit të Rritjes të BE-së.

 05/06/2025

 10:00 – 12:00

 Marriott Tirana, Amantia

Që prej **miratimit** të Agjendës së Reformave në nëntor të vitit të kaluar, Shqipëria ka hyrë në një etapë të re të integritimit në BE—një fazë ambicioze në përmbajtje dhe e pashembullt në mbështetjen financiare dhe politike që ka gjeneruar. Në kuadër të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, Shqipëria pritet të përfitojë deri në **922 milionë euro** deri në vitin 2027. Disbursimi fillestar në formën e **parafinancimit** prej **64.5 milionë euro** tashmë është kryer, duke shënuar fillimin konkret të këtij angazhimi shumëvjeçar.

Progresi po merr gradualisht formë. Në shkurt 2025, Shqipëria dorëzoi raportin e parë mbi hapat e ndërmarra, i cili është aktualisht në vlerësim nga Komisioni Evropian. Pas raportit të qershorit 2025, një tjetër disbursim prej **127.8 milionë euro** mund të pasojë, nëse përmbushen **18 hapat** e parashikuara në pesë fushat prioritare të politikave.

Ky proces është shoqëruar me hapa kyç institucionalë. Në mars, Shqipëria ratifikoi marrëveshjet e **huasë** dhe të **facilitetit**. Në maj, Këshilli i Ministrave **miratoi** strukturat kombëtare të koordinimit dhe raportimit, duke i dhënë formë institucionale zbatimit të reformave. Brenda këtij kuadri, **SASPAC**, si Koordinatori Kombëtar, do të krijojë së bashku me Komisionin Evropian **Komitetin Monitorues të Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF)**. Ky komitet do të përfshijë përfaqësues të shoqërisë civile dhe të biznesit, dhe do të mbledhet një herë në vit për të shqyrtuar ecurinë e reformave dhe për të nxitur llogaridhënien.

Megjithatë, veprimi institucional nuk mjafton. Zbatimi i reformave kuptimplota kërkon përfshirjen aktive të aktorëve shoqërorë—organizatave, ekspertëve dhe komuniteteve—të cilët mund të kontribuojnë në zbatim dhe monitorim të pavarur. Për këtë qëllim, **IDM Albania** ka krijuar platformën **N-CoMER** si një hapësirë për dialog ndërsektorial. Qëllimi i saj është të forcojë zërin e shoqërisë civile në drejtim të një procesi reformash gjithëpërfshirës dhe transparent.

Kjo tryezë e parë do të mbledhë së bashku aktorët shoqërorë, institucionalë dhe partnerë ndërkombëtarë për të shqyrtuar ecurinë e Agjendës së Reformave, diskutuar rolin e strukturave kombëtare të konsultimit dhe koordinimit, si dhe eksploruar strategji gjithëpërfshirëse për zbatimin e saj.

Eventi do të zhvillohet më datë **5 qershor, ora 10:00 – 12:00, në Marriott Tirana, salla Amantia**. Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj deri më 3 qershor!



PROGRAMI

09:45 – 10:00	MIRËSEARDHJA
	FJALIMET HYRËSE
10:00 – 10:30	Z. Sotirag Hroni, Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim Z. Hubert Perr, Shefi i Bashkëpunimit, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri Znj. Eridana Cano, Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës
	PLATFORMA E DIALOGUT DHE MONITORIMIT
10:30 – 10:40	Z. Daniel Prroni, Hulumtues, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
	AGJENDA E REFORMAVE NË VEPRIM
10:40 – 11:10	<i>Ndërhyrje nga:</i> Znj. Elona Bano, Drejtorja e Integritetit dhe Negociatave, Ministria e Drejtësisë Znj. Fotjona Taçe, Drejtore Kabineti, Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Anti-korrupsionin Përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (TBC) Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (TBC)
	AGJENDA E REFORMAVE NË PERSPEKTIVË
11:10 – 11:45	<i>Diskutim nga:</i> Z. Erjon Muharremaj, Profesor, Universiteti i Tiranës Znj. Blerjana Bino, SCiDEV Znj. Zana Vokopola, Urban Research Institute
11:45 – 12:00	DISKUTIM I HAPUR DHE KËNDVËSHTRIMET E AKTORËVE SHOQËRORË